



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës: KSC-CC-2022-13
KSC-CC-2022-14
KSC-CC-2022-15

Vendosi: Kryetarja e Dhomave të Specializuara
Gjykatëse Ekaterina Trendafilova

Data: 1 mars 2022

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

Vendim për Caktimin e Gjykatësve të Panelit të Gjykatës Kushtetuese

Gjykatësve të Panelit të Gjykatës Kushtetuese:

Gjykatës Vidar Stensland

Gjykatës Roumen Nenkov

Gjykatëse Romina Inkuti

Mbrojtjes së Hashim Thaçit:

Gregori Kihou

Mbrojtësit të Kadri Veselit:

Ben Emerson

Zyrës së Prokurorit të Specializuar:

Xhek Smith

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit:

Venkatesvari Alagenda

KRYETARJA e Dhomave të Specializuara (“Kryetarja”), duke vepruar në bazë të nenit 33(3) të Ligjit Nr. 05/L-053 për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar (“Ligji”) dhe rregullat 3 dhe 4(2) të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve të Dhomave të Specializuara nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë (“Rregullorja për Caktimin e Gjykatësve”), me anë të këtij vendimi cakton Panelin e Gjykatës Kushtetuese për të vendosur në lidhje me: (i) “Kërkesën Referuese të Mbrojtjes së Krasniqit drejtuar Panelit të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me Ligjshmërinë e Akuzës së Ndërmarrjes Kriminale të Përbashkët me Shtojcën 1, Publike”;¹ (ii) “Kërkesën Referuese të Kadri Veselit kundër Vendimit mbi Apelet kundër Vendimit mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime lidhur me Juridiksionin e Dhomave të Specializuara”;² dhe (iii) “Kërkesën Referuese drejtuar Panelit të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me Shkeljen e të Drejtave Themelore të z. Thaçi për një Gjykatë të Pavarur dhe të Paanshme Themeluar me Ligj dhe për Mendim të Arsyetuar”³ (bashkërisht “Kërkesat Referuese”).

I. HISTORIKU PROCEDURAL

1. Më 22 korrik 2021, Gjykatësi i Procedurës Paraprake lëshoi vendimin mbi mocionet e z. Hashim Thaçi, z. Kadri Veseli dhe z. Jakup Krasniqi që ngrinin kundërshtime lidhur me juridiksionin e Dhomave të Specializuara (“Vendimi i Kundërshtuar”).⁴

2. Më 23 dhjetor 2021, Paneli i Gjykatës së Apelit, ndër të tjera, rrëzoi apelet e paraqitura nga z. Thaçi, z. Veseli dhe z. Krasniqi kundër Vendimit të Kundërshtuar.⁵

¹ KSC-CC-2022-13/F00001, Kërkesë Referuese e Mbrojtjes së Krasniqit drejtuar Panelit të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me Ligjshmërinë e Akuzës së Ndërmarrjes Kriminale të Përbashkët me Shtojcën 1, publike, 28 shkurt 2022.

² KSC-CC-2022-14/F00001, Kërkesë Referuese e Kadri Veselit kundër Vendimit mbi Apelet kundër Vendimit mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime lidhur me Juridiksionin e Dhomave të Specializuara, 28 shkurt 2022.

³ KSC-CC-2022-15/F00001, Kërkesë Referuese drejtuar Panelit të Gjykatës Kushtetuese në lidhje me Shkeljen e të Drejtave Themelore të z. Thaçi për një Gjykatë të Pavarur dhe të Paanshme Themeluar me Ligj dhe për Mendim të Arsyetuar, 28 shkurt 2022.

⁴ KSC-BC-2020-06/F00412, Vendim mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime lidhur me Juridiksionin e Dhomave të Specializuara, 22 korrik 2021, para. 214.

⁵ KSC-BC-2020-06/IA009/F00030, Vendim mbi Apelet kundër Vendimit mbi Mocionet që Ngrenë Kundërshtime lidhur me Juridiksionin e Dhomave të Specializuara, 23 dhjetor 2021, para. 237.

3. Më 28 shkurt 2022, z. Thaçi, z. Veseli dhe z. Krasniqi dorëzuan Kërkesat Referuese.

II. CAKTIMI

4. Pas parashtrimit të një kërkesë referuese në Dhomat e Specializuara të Gjykatës Kushtetuese ("DHSGJK"), bëhet caktimi i tre gjykatësve të DHSGJK-së në pajtim me nenin 33(3) të Ligjit. Në rast pamundësie të kryerjes së detyrës prej njërit nga këta gjykatës, Kryetarja cakton gjykatësin kushtetues rezervë.

5. Në lidhje me këtë , Kryetarja vëren se një nga tre gjykatësit e DHSGJK-së nuk ka mundësi ta kryejë këtë detyrë. Rrjedhimisht, Kryetarja cakton gjykatësin kushtetues rezervë, në pajtim me nenin 33(3) të Ligjit dhe rregullën 4(2) të Rregullores për Caktimin e Gjykatësve.

PËR ARSYET E LARTPËRMENDURA, KRYETARJA

cakton si më poshtë gjykatësit në përbërje të Panelit të Gjykatës Kushtetuese për të vendosur në lidhje me Kërkesat Referuese:

Gjykatës Vidar Stensland

Gjykatës Roumen Nenkov

Gjykatëse Romina Inkuti

/nënshkrimi/

**Gjykatëse Ekaterina Trendafilova,
Kryetare e Dhomave të Specializuara**

E martë, 1 mars 2022

Në Hagë, Holandë